

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-26-2648-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Hartimi, riprogramimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave të sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Prizrenit**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>" Informatika Computers " Sh.p.k.</b>
NUI	<b>600148987</b>
Adresa	<b>Mitrovice</b>
Vendi	<b>Prishtine</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>+38349760111</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Riza Ibrani</b>
Adresa elektronike	<b>info@rikont-ks.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>10.06.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Hartimi, riprogramimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave të sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Prizrenit**

**Data e njoftimit për kontratë: 23.04.2026**

**Sqarimi i Dosjes së Tenderit : 08.05.2026**

**Hapja e Tenderëve : 14.05.2026**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

**Me datën 10.06.2026 ne kemi bërë kërkesë për Rishqyrtim e cila pastaj është refuzuar si e pa bazuar.**

### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Shkelje e nenit 7 të LPP - Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit;
2. Shkelje e nenit 27 të LPP - Dosja e Tenderit

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Shkelje e nenit 7 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë - Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili obligon autoritetet kontraktuese të sigurojnë trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe transparencë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka konsideruar si mangësi eliminuese mungesën e emrit të procedurës dhe numrit të prokurimit në Deklaratën nën Betim, ndonëse formulari i publikuar nga vetë Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit nuk i përmbante këto të dhëna. Duke e bazuar vendimin në një kërkesë që nuk ishte e përcaktuar qartë në dokumentacionin e tenderit, Autoriteti Kontraktues ka cenuar parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Shkelje e Nenit 27 të LPP-së - Dosja e Tenderit

Në kundërshtim me Nenin 27 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues ka penalizuar Operatorin Ekonomik për një element që nuk ishte i përfshirë në formularin standard të publikuar në dosjen e tenderit. Ne si OE kemi vepruar në përputhje me dokumentacionin e tenderit të përgatitur nga vetë Autoriteti Kontraktues dhe nuk mund të mbahemi përgjegjës për mungesa që rrjedhin nga formularët zyrtarë të publikuar nga ky i fundit.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*